



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE
Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr.

1932

Prishtinë, Dt.

19.06.2025

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Shkencave Matematike dhe Natyrore
Departamenti/ Programi	Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit
Projektpropozimi	Identifikimi i zonave potenciale të mbrojtura në komunën të komunës së Kamenicës, Hanit të Elezit dhe Ranillugut
Kandidati/ja	Linda Çavdarbasha
Mentori	Prof.Dr. Behxhet Mustafa
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 28.02.2025 Vendimi nr.: 682
Vlerësimi i dorëshkrimit	<p>Tema e masterit "Identifikimi i zonave potenciale të mbrojtura në komunën të komunës së Kamenicës, Hanit të Elezit dhe Ranillugut" e kandidates Linda Çavdarbasha është punuar në Departamentin e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore përkatësisht në laboratorin e Ekologjisë së Bimëve dhe Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës — IKMN, në kuadër të Agjensionit të Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit — AMMK, në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë. Tema është realizuar sipas procedurave dhe dinamikës së paraparë në programin e punës të paraqitur së bashku me kërkesën për vlerësimin të projekt-propozimit të temës.</p> <p>Dorëshkrimi është shkruar në 91 faqe, me rralloz 1.5 ku janë përfshirë këta kapituj: Abstrakti, Abstract (në gjuhën Angleze), Hyrja, Qëllimi i hulumtimit, Materiali dhe metodat e punës, Rezultatet dhe diskutimi, Përfundimi, Literatura dhe Jetëshkrimi. Në punim janë të prezantuara 49 figura (foto dhe harta) dhe 3 tabela. Kandidatja gjatë shkruarjes së dorëshkrimit ka shfrytëzuar</p>

literaturë të mjaftueshme duke cituar 14 artikuj shkencor dhe burime tjera të literaturës. Në kapitullin Hyrje, kandidatja përshkruan historikun e fillimit të futjes nën mbrojtje të zonave dhe objekteve natyrore në botë, masat e para për shpalljen e zonave të mbrojtura në Kosovë që kanë filluar nga viti 1950, dhe trendin e rritjes së sipërfaqeve dhe objekteve natyrore të mbrojtura me ligj në Kosovë prej atëherë e deri më tash. Te Qëllimi i hulumtimit kandidatja sqaron rëndësinë e hulumtimit të saj në identifikimin e zonave potenciale të mbrojtura dhe adreson qartë qëllimin e këtij hulumtimi në komunën e Kamenicës, Hanit të Elezit dhe Ranillugut.

Në kapitullin Materiali dhe metodat, tregon se realizimi i këtij punimi është bërë në kuadër të iniciativës së Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, për identifikimin e zonave potenciale për mbrojtje në komunën e Novobërdës dhe komunën e Prizrenit. Kandidatja përshkruan në detaje materialin dhe metodat e përdorura në këtë hulumtim, përfshirë dizajnin e punës në terren, karakteristikat e përgjithshme të territorit të komunës së Kamenicës, Hanit të Elezit dhe Ranillugut, mënyrën e identifikimit të zonave dhe objekteve për mbrojtje, mënyrën e kategorizimit të tyre. Në kapitullin Rezultatet dhe diskutimi, kandidatja përshkruan dhe analizon rezultatet e gjetura për zonat dhe objektet e rëndësishme natyrore në komunën e Kamenicës, Hanit të Elezit dhe Ranillugut. Në fshatrat e komunës së Kamenicës, janë identifikuar 25 objekte të trashëgimisë natyrore me karakter botanik dhe gjeomorfologjik. Ndërsa Institutit i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës vetëm trembëdhjetë (13) prej këtyre objekteve i ka propozuar për monumente të natyrës me karakter botanik dhe për vënien e tyre nën mbrojtje ligjore. Ndërsa një (1) me karakter gjeomorfologjik. Në komunën e Hanit të Elezit janë identifikuar gjashtë (6) objekte të karakterit hidrologjik, gjeomorfologjik dhe botanik. Në komunën e Ranillugut është identifikuar një (1) objekt i karakterit gjeomorfologjik.

Në kapitullin Përfundimi, kandidatja jep një rezymë të rezultateve të arritura. Në bazë të rezultateve të fituara kandidatja konstaton se në komunën e Kamenicës janë të identifikuar 25 objekte të karakterit botanik dhe gjeomorfologjik. Kandidatja sqaron se nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës — IKMN, në kuadër të Agjencionit të Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit — AMMK, në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë është propozuar që komuna e Kamenicës të shpallë nën mbrojtje këto 13 objekte të karakterit botanik dhe 1 të karakterit gjeomorfologjik. Kandidatja për komunën e Hanit të Elezit konstaton se nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës janë propozuar 6 objekte të karakterit hidrologjik, gjeomorfologjik dhe botanik. Në komunën e Ranillugut kandidatja konstaton se është propozuar 1 objekt i karakterit gjeomorfologjik.




Kandidatja konkludon se rezultatet e fituara në këtë punim në suazë të komunës së Kamenicës,

Hanit të Elezit dhe Ranillugut, paraqesin kontribut për njohjen e vlerave natyrore të veçanta në vendin tonë dhe nevojën për mbrojtje ligjore të tyre.

Këshillit Shkencor-Mësimor të Departamentit të Biologjisë dhe të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore i propozojmë që të aprovoj këtë raport dhe kandidates Linda Çavdarbasha ti lejoj mbrojtjen e temës.

Prishtinë, 18.06. 2025

Komisioni:

1. 
/ Prof. Dr. Avni Hajdari – kryetar/
2. 
/ Prof. Dr. Behxhet Mustafa – anëtar
(mentor)
3. 
/ Prof. Dr. Avdullah Alija – anëtar/

